

QËNDRIMET NË PARLAMENTIN SHQIPTAR PËR ÇËSHTJEN E KOSOVËS (1920-1924)

Përmbledhje e kumtesës

Mbi bazën e dokumentacionit të viteve 1920-1924, që pasqyron jetën parlamentare e më gjerë, dhe veprimtarinë e parlamentit, qeverive dhe përgjithësisht të elitës politike të kohës lidhur me çështjen e Kosovës, qoftë territoriale, apo për të drejtat kombëtare e njerëzore, dalin disa konkluzione e përcillen disa mesazhe me vlerë aktuale.

Së pari, duhet theksuar se aspekti i çështjes që ka të bëjë me pretendimet territoriale, përkatësisht rikthim brenda shtetit shqiptar të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare të shkëputura në 1913-ën, qysh në muajt e parë të vitit 1920, konsiderohej një çështje e mbyllur për shkak të qëndrimit pa ekuivoke të Fuqive të Mëdha. Për trajtim të mëtejshëm ishte lënë vetëm rektifikimi në disa segmente, i kufirit të 1913-ës. Aspekti tjetër i çështjes së Kosovës lidhet me mbrojtjen e të drejtave kombëtare e njerëzore të popullsisë shqiptare që do të duhej të jetonte në shtetet fqinjë sipas normave të fiksuara në legjislacionin ndërkombëtar për mbrojtjen e minoriteteve.

Rezultoni se debatet për çështjen në fjalë midis pozitës dhe opozitës, në parlament por edhe jashtë saj, karakterizohen nga një qëndrim më agresiv i opozitës dhe nga një prononcim më i moderuar i pozitës. Pavarësisht nga origjina krahinore, sentimentet, interesat personale të deputetëve të veçantë ose të grupeve të deputetëve, që lidheshin me trevat e lëna jashtë Shqipërisë me vendime të faktorit ndërkombëtar, ishte më e lehtë për opozitën t'i kërkonte pozitës atë që nuk do ta bënte vetë kur ishte në pozitë. Gjashtëmujori i dytë i vitit 1924 tregoi këtë të vërtetë, që me sa duket është universale.

Rezultoni gjithashtu se pavarësisht nga intensiteti i trajtimit parlamentar, apo dhe mediatik, i problemeve që lidhen me çështjen e Kosovës etj., demarshet zyrtare të nivelit shtetëror, parlamentar apo qeveritar, në kancelaritë e Fuqive të Mëdha dhe në forume të tillë ndërkombëtarë si Lidhja e Kombeve (për mbrojtjen e të drejtave të shteteve e popujve), apo Konferenca e Ambasadorëve (për rektifikimet kufitare), ishin të rralla dhe vetëm në raste të vënies në lojë të gjithë interesave, si edhe në raste të acarimeve e përplasjeve deri me armë me fqinjët (përkatësisht shtetin SKS, apo Jugosllavinë). Kështu ndodhi në verë-vjeshtën e vitit 1920 dhe 1921, kur përballë intervencionit jugosllav në Koplik e Peshkopi, elita politike në Shqipëri ishte e detyruar të luante fort, i duhej patjetër të krijonte unitet d.m.th., unifikim të qëndrimeve pozitë-opozitë, dhe gjithashtu i duhej të mbante qëndrime për konsum të brendshëm, d.m.th. përpara popullit, natyrisht edhe kur gjendej diku te faktori i jashtëm një mbështetje, qoftë edhe me kosto të lartë, sikurse ishte rasti i mbështetjes tek Italia për të përballuar Jugosllavinë e Greqinë dhe anasjelltas.

Vërehet se në rastin e këtyre acarimeve, përveç demarshëve zyrtare shtetërore, shtoheshin dhe veprimet propagandistike jashtë vendit, përmes promemorieve e protestave të individëve e grupeve të caktuara, veprimet e lobimet e të cilëve, apo edhe të miqve të huaj të Shqipërisë, nuk

implikonin drejtpërdrejt shtetin shqiptar. Kështu më 1921, prof. Bedri Pejani mbajti një referat të shkëlqyer të natyrës irredentiste dhe në mbrojtje të shqiptarëve në Jugosllavi e Greqi duke shfrytëzuar një Kongres në Zvicër, organizuar nga Shoqëria e Popujve të Rrezikuar, me qendër në Göttingen të Gjermanisë, ku e djathta gjermane me prirje fashiste dhe jo vetëm gjermane, shfrytëzonte vendimet e rënda për të mundurit e Luftës së Parë Botërore, të marra nga Konferenca e Paqes, për të kërkuar revansh. Po kështu, më 1924 promemorie të firmosura nga H. Prishtina, B. Curri etj., iu adresuan Lidhjes së Kombeve. Nga parlamentarët shqiptarë rezultoi se sekretari i Lidhjes së Kombeve, Erik Drummond, kishte patur vetëm një prononcim për të drejtat e shqiptarëve në Jugosllavi në vitin 1921, pikërisht kur Parlamenti Jugosllav paralelisht kishte reaguar për këtë çështje duke e quajtur hapin zyrtar të parlamentit ndërhyrje në punët e brendshme të Jugosllavisë.

Nëse vështrojmë periudhat e veprimeve të sipërpërmendura të autoriteteve më të larta të Shqipërisë, që nga viti 1912, rezultoi se pas 28 Nëntorit dhe Shpalljes së Pavarësisë deri në fund të viteve 20, elita politike shqiptare e kohës, e organizuar deri më 1920 në forma paraparlamentare, kishte qenë më unike e kishte reaguar më fort, duke paraqitur edhe kërkesa territoriale. Por kjo kishte ndodhur deri në verën e vitit 1913, kur ende nuk ishin caktuar kufijtë e Shqipërisë, ose në shkurt 1919, kur shpeshohej dhe ishin krijuar iluzione se ndoshta Konferenca e Paqes e Parisit mund të korrigjonte arbitrazhin katastrofik të vitit 1913, të Konferencës së Ambasadorëve. Në këto raste shqiptarët kishin në favor të tyre në fillim Austro-Hungarinë dhe Italinë (më 1912-1913), kurse më pas shpresonin në premtimet e Italisë (më 1919).

Periudha 1920-1924 kishte për Shqipërinë një mbështetje të vakët të Britanisë (që ndikoi në futjen e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve), por që ishte po kaq e interesuar të ruante ekuilibrat në Ballkan e Mesdhe, të kishte peshë në Mbretërinë Jugosllave, të dominonte politikën e Greqisë dhe të ekuilibronte interesat e Italisë dhe Francës për Ballkanin. Prandaj “miku i madh” i kohës, ndërkohë që pas Konferencës së Paqes, SHBA ishte vetizoluar përtej Oqeanit Atlantik, i vetmi “mik potencial”, Britania e Madhe, nuk lejonte më tepër se të ruhej Shqipëria e 1913-ës, duke i njohur një përparësi të lehtë Italisë në krahun lindor të kanalit të Otrantos, kurse Tirana zyrtare jo vetëm nuk mund të kërkonte territoret e Kosovës e më gjerë, por nuk mund të ngrinte me forcë as çështjen e trajtimit të shqiptarëve në Jugosllavi, sikurse kërkonte Traktati për Minoritetet i firmosur edhe nga Jugosllavia. Aq i kujdesshëm ishte qëndrimi britanik në trajtimin e çështjeve të rajonit, sa edhe kur Shqipërisë, gjatë interpretimit të pikave të caktuara të kufijve të 1913-ës, iu njoh e drejta mbi manastirin e Shën Naumit, asaj nuk iu dha asnjë ndihmë konkrete për të marrë atë territor. Kujtojmë se kur kishin anësi të qartë në konfliktet rajonale Fuqitë e Mëdha ndërhynin drejtpërdrejt, sikurse ishte, më 1881, rasti i demonstratës ushtarake në Ulqin për ta detyruar Perandorinë Osmane ta shpartallonte vetë mbrojtjen shqiptare të qytetit dhe t’ia dorëzonte atë Malit të Zi.

Edhe pas vitit 1924, Parlamenti Shqiptar në fakt, monokolor dhe tërësisht i dirigjuar nga presidenti A. Zogu I (1925-1928) e më pas mbreti A. Zogu I (1928-1939) nuk ndërmoi veprime serioze diplomatike për të trajtuar çështjen e të drejtave kombëtare e njerëzore të shqiptarëve të Kosovës. Shteti shqiptar luajti në këtë fushë vetëm përmes *promemorieve, jo zyrtare*, si ato të H.

Prishtinës më 1927 dhe 1929, apo si promemoria e tre priftërinjve katolikë, dom Gjon Bisakut, dom Shtjefën Kurtit dhe dom Luigj Gashit, të arratisur nga Jugosllavia pas vrasjes së priftit tjetër katolik, at Shtjefën Gjeçovit, apo duke bërë ç'mund të bëhej përmes diplomatëve shqiptarë në Beograd e Shkup, gjithashtu duke nxitur të vepronin figura potenciale politike ndër shqiptarët që jetonin e vepronin në Jugosllavi, si Ferhat Draga, ose përmes agjunkturës së saj të dobët atje, të cilët sponsorizoheshin përmes fondeve modeste etj.

Komiteti “MKK”, apo edhe artikuj të rrallë në ndonjë gazetë që botohej jashtë shtetit, nuk mund të ngrinin veçse fare zbehtë zërin për çështjen e të drejtave të shqiptarëve në Jugosllavi.

Është vendi të përmendim se kur, pas largimit nga Vlora, Italia, në muajt e fundit të vitit 1920, nuk do të përbënte më rrezikun kryesor për Shqipërinë dhe e tillë ajo do të ishte deri në fund të viteve 20 dhe kur situata e brendshme në Shqipëri nuk kishte konfrontime madhore, që të spostonin vëmendjen (më 1920-1921, 1924, dhe më 1927-1930), u prodhuan edhe reagimet zyrtare, ose promemoret e fuqishme jozyrtare, të sipërpërmendura. Ka fakte se ato ishin të nxitura edhe nga shteti shqiptar, në rastet kur ai kishte ose ndjente suportin, në mos shtytjen e politikës së Romës, e pjesërisht, miratimin, në skalionin e dytë, të Britanisë së Madhe për të “ngacmuar” Jugosllavinë. (*Promemoria e Bedri Pejanit 1921*, në emër të “Komiteteve të Bashkuara të Shqiptarëve Irredentë”, paraqitur më 1-10 shtator në Kongresin Ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të popujve (në të cilën përmendej edhe e drejta e vetëvendosjes), *Promemoria e H. Prishtinës, B. Currit dhe B. Pejanit e 26 shtatorit 1924*, paraqitur Lidhjes së Kombeve më 1924, *Promemoret e Hasan Prishtinës më 15 mars 1927, dhe 5 prill 1929, dhe 10 janar 1931. Promemoria e tre priftërinjve katolikë të arratisur nga Jugosllavia më 5 maj 1930 etj.*).

Tipare të ngjashme vihen re për çështjen në fjalë, edhe në qëndrimet politike të Shqipërisë së Pasluftës. Shqipëria e Bllokut Lindor nuk u ndje fare të reagoonte për çështjen e Kosovës deri në vitin 1948 dhe vetëm me raste e bëri këtë edhe më vonë kur do të duhej që BRSS ose Kina të miratonin veprime të politikës së jashtme të Shqipërisë. Interesat e tyre të veçanta për Federatën e Titos, ia lidhnin gojën Shqipërisë së Enverit dhe parlamentit të saj fiktiv.

Ndërkohë, në dukje paradoksale, por është e vërtetë se për çështjen e Çamërisë, që ishte territor i Greqisë “monarko-fashiste” e aleate e “fuqive imperialiste”, zëri i Tiranës zyrtare u ngrit jo pak në vitet e para të pasluftës. Madje në këtë kohë në Shqipëri u strehuan e mjekuan edhe luftëtarët e EAM-it (të majtës greke) të përfshirë në luftën civile në Greqi, që vijoi deri më 1949. Këto qëndrime, në rastin e dytë komprometues për qeverinë shqiptare, ishin të lidhura me politikën e Bllokut Lindor ku Shqipëria bënte pjesë.

Konkluzionet dhe mesazhet që vijnë nga pozicionimi i parlamentit dhe qeverisë shqiptare të viteve 1920-1924, janë të qarta. Ato kanë vlerë universale dhe të japin mundësi të gjykosh edhe veprimtarinë parlamentare e qeveritare të ditëve tona, ku shpesh palët në pozitë e opozitë e kalojnë cakun e akuzave për probleme që pala akuzuese e di mirë që s'mund të jenë ndryshe dhe askush nuk ka hapësirë t'i trajtojë ndryshe po të kishte radhën për t'i trajtuar.

BURIMET DHE LITERATURA KRYESORE

I. Arkivat

Arkivi i Institutit të Historisë (AIH), Tiranë

Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSh), Tiranë

II. Botime dokumentare

Bisedimet e Këshillit Kombtar (1920, 1921), përgatitur nga Shërbimi i Botimeve Parlamentare të Kuvendit të Shqipërisë, Tiranë: 2015

Bisedimet e Këshillit Kombtar, Tiranë: Nikaj, 1922

Documenti (I) Diplomatici Italiani, Settima Serie (1922-1935), vol. I (31 ottobre 1922 – 26 aprile 1923), Ministero degli Affari Esteri, Roma: 1953

Dokumente e materiale historike nga lufta e popullit shqiptar për liri e demokraci 1917-1941, botim i Drejtorisë së Arkivave Shtetërore të RPSH, Tiranë: 1959

Hasan Prishtina: Përmbledhje dokumentesh (1908-1934), përgatitën për botim Kujtim Nuro, Nezir Bata, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Tiranë: 1983

Lufta e popullit shqiptar për çlirimin kombëtar 1918-1920 (përmbledhje dokumentesh), përgatitur nga Muin Çami dhe Hidajete Luga (Bejtja) në bashkëpunim me Dhimitër Andonin, Mediha Shuteriqin dhe Zekeria Rexhën, vëll. I, II, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Tiranë: 1975

PUTO, Arben - *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare pas Luftës I Botërore,* vëll. III (1919-1926), Tiranë: Albin, 2001

NOSI, Lef - *Dokumente historike për t'i shërbye histories tonë kombëtare,* botimi i dytë, Tiranë, 2007

Qarkoret e Ministrisë së Punëve të Brendshme të vjetit 1920, Shkodër: Nikaj, 1921

Shën Naumi dhe diplomacia e kohës, përgatiti për botim Kaliopi Naska, Tiranë: Kristalina-KH, 2012

Shqipnia përpara Konferencës së Paqës, Blë i Parë (Dokumenta zyrtarë të paraqitun nga ana e Dërgatës Shqiptare, qyshë prej 12 Shkurt e deri më 5 Qershor 1919, e të botuem nga ana e Qeverriës së Përkohëshme), Romë: 1919

Blë i Dytë (Dokumenta zyrtarë të paraqitun nga ana e Dërgatës Shqiptare qyshë prej 24 Korrik 1919 e deri më 11 Shkurt 1920 e të botuem nga ana e Qeverriës Shqiptare), Shkodër: Shtypëshkroja Franqiskane, 1921

III. Literaturë historiografike, ditare e kujtime

- ABDYLI, Tahir - *Hasan Prishtina në lëvizjen kombëtare e demokratike shqiptare (1908-1933)*, Prishtinë: 1990
- BOLETINI, Tafil - *Kujtime*, përg. për botim M. Verli, Tiranë: Botimpex, 2003 (ribotim Tiranë: Klean 2011)
- ÇAMI, Muin & VERLI, Marenglen - *Shqipëria në Konferencën e Paqes (1919-1920)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2015
- CICI, Arben - *Marrëdhëniet shqiptaro-italiane në vitet 1920-1934*, Tiranë: UET Press, 2013
- FISCHER, Bernd J. - *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri*, Tiranë: Çabej, 1996
- Fjalor Enciklopedik Shqiptar*, vëll. I, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2008
- Historia e Popullit Shqiptar*, vëll.III, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2007
- Historia e Shqipërisë*, vëll. III (1912-1944), botim i Institutit të Historisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: 1984
- Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëll. II, ASA, Instituti i Historisë, Tiranë: 2019
- KRASNIQI, Afrim - *Partitë politike në Shqipëri (1920-2006) historia dhe tiparet e partive, të parlamenteve dhe të zhvillimeve politike*, ISP, Tiranë: Eurorilindja, 2006
- MILO, Paskal - *Politika e jashtme e Shqipërisë*, vëll. I (1912-1939), Tiranë: Toena, 2013
- MILO, Paskal - *Shqipëria dhe Jugosllavia 1918-1927*, Tiranë: Shtëpia Botuese Enciklopedike, 1992
- PRIFTI, Kristaq *Popullsia e Kosovës (1831-1912)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2014
- PUTO, Arben - *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit (1912-1918)*, vëll.II, Tiranë: 8 Nëntori, 1987
- PUTO, Arben - *Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha (1912-1914)*, Tiranë: 8 Nëntori, 1978
- PUTO, Arben - *Shqipëria politike (1912-1939)*, Tiranë: Toena, 2009
- SWIRE, Joseph - *Shqipëria - Ngritja e një mbretërie*, Tiranë: Dituria, 2005
- TELI (DIBRA), Pranvera - *Shqipëria dhe diplomacia angleze (1919-1927), nën dritën e burimeve arkivore angleze*, Tiranë: Neraida, 2005
- VERLI, Marenglen - *Kosova - sfida shqiptare në historinë e një shekulli*, Tiranë: Botimpex, 2007
- VLLAMASI, Sejfi - *Ballafaqime politike në Shqipëri (1897-1942). Kujtime dhe vlerësime historike*, përgatiti për botim Marenglen Verli, Tiranë: Neraida, 2000
- VLORA, Ismail Qemal - *Kujtime*, Tiranë: Toena, 1997